



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 52/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Vlastimir Dimić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të fillimit të fushatës zgjedhore para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetarë të Komunës së Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 24.04.2012, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** poshtë ankesa si e palejuar.

### Arsyetim

PZAP-i, me datën 22.04.2012, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK, dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se subjekti politik LDK, me datën 22.04.2012, ka vendosur postera me foton dhe numrin e kandidatit të propozuar të këtij subjekti politik Adem Salihaj, në vende publike më saktësisht vendosja e posterave të kandidatit në fjalë është bërë në rrugën “Bill Klinton”, te Palestra e Sporteve, si dhe në rrugën “Ibrahim Ademi”, në Komunën e Ferizajt, para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë rast është bërë shkelje e Rregullës Zgjedhore, Nr.13/2009 *Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike*, dhe e Rregullës Zgjedhore, Nr.11/2009 *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, pasi që periudha zyrtare e fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, fillon nga data 23 deri 27 Prill 2012.*

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotot që përmbajnë posterat e kandidatit për Kryetar të Komunës së Ferizajt nga radha e subjektit politik të LDK-së.

Neni 33 dhe 44 i LZP-së, Rregulla Zgjedhore nr. 11/2009, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët* dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2009 *Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike*, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, siç del nga të gjitha dispozitat ligjore dhe Rregullat Zgjedhore të lartcekura, ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësit e tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

PZAP-i nga shkresat e lëndës gjeti se:

**ankesa është e palejuar.**

Meqenëse pretendimet e parashtruara në ankesë nuk janë bërë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe në këtë rast nuk kemi të bëjmë me shkeljen e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, në pajtim me dispozitat e cituara ligjore PZAP-i, konstaton se nuk kemi të bëjmë me veprimet e ndaluara të subjekteve politike, ngase në LZP dhe në Rregullat zgjedhore të KQZ-së, nuk është paraparë asnjë dispozitë ligjore që ndalon ose sanksionon vendosjen e posterave publike apo fillimin e fushatës zgjedhore para datës së caktuar për fushatë zgjedhore.

Në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

A nr. 52/2012 më datën 24.04.2012.

